



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-(SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)



Në bazë të nenit 79 paragrafi 2 nenet 80,81,82,83 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Rregullore (QRK) Nr. 30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik, Rregullorën Nr.27/2024 për Procedurat e konkurrimit për nëpunësit teknik dhe mbështetës, Sektori i Burimeve Njerëzore i SHSKUK-së, shpall:

KONKURS PUBLIK

Nr	Institucioni	Pozita	Klasa	Kohëzgjatja e kontratës së punës	Nr.references	Numri i kërkuar i pozitave
1	QSHM-Shtëpia Integrim në Bashkësi-Gjilan	Mjek specialist-psikiater	H8	Kohë të pacaktuar	05/2025/4	1
2	QSHM-Shtëpia Integrim në Bashkësi-Gjilan	Infermier/e-shkolla e meseme	H19	Kohë të pacaktuar	05/2025/4	1
3	QSHM-Shtëpia Integrim në Bashkësi-Gjilan	Këshilltar psikosocial	H16	Kohë të pacaktuar	05/2025/4	1
4	QSHM-Shtëpia Integrim në Bashkësi-Gjilan	Roje	I23	Kohë të pacaktuar	05/2025/4	1

Detyrat dhe Përgjegjësitë Mjek specialist/ psikiater:

- Të punoj në Qendrën e Shëndetit Mendor në Bashkësi: në koordinim me profile të tjera profesionale (punëtorin social, këshilltarin psikosocial, psikologun, psikiatër të tjerë dhe teknikë) në qendër duke u bazuar në principet e punës në ekip;
- Të kontribuojë në koordinimin dhe organizimin e ekipit të shëndetit mendor, që ti përgjigjet nevojave reale të përkujdesjes së shëndetit mendor të klientëve dhe ofrimin e shërbimeve më të mira (orari i punës, llojet e aktiviteteve etj.);
- Të bëjnë vlerësimin, diagnostifikimin, trajtimin dhe përcjelljen psikiatrik/e të klientëve në qendër dhe në mjedisin ku ata jetojnë.Të bëjnë dhe të përcjellin gjendjen e përgjithshme shëndetësore apo të problemeve të tjera shëndetësore të klientëve;
- Të punojnë në baza territoriale me përgjegjësi për shëndetin mendor të një popullatë të caktuar në njësi të caktuara territoriale;
- Të bëjnë vizita klientëve ose personave të tjerë relevantë që kanë të bëjnë me klientin në shtëpi, vendin ku jetojnë së bashku me pjesën tej të stafit.Të punojnë me klientë duke ofruar një spektër të gjërë intervenimeve apo aktivitete terapeutike që kanë baza të shëndosha shkencore. (intervenime individuale apo në grup, psikoterapi, psiko-edukim, terapi suportive apo familjare) dhe të verësojnë gjendjen e klientëve në periudha të caktuara;
- Të garantojë vazhdueshmërinë e përkrahjes së marrëdhënies terapeutike në mes të shërbimeve të shëndetit mendor dhe shfrytëzuesit si dhe familjes së tij/saj;
- Të garantojë përgjigje të duhur, fleksibile dhe me “kohë të duhur/reale” nga QSHM-SHIB ndaj nevojave të shfrytëzuesve (shmangja e listave të pritjes etj.);

- Të identifikohen nevojat sociale të klientëve dhe të informon dhe bashkëpunon me punëtorin social për intervenimet e nevojshme;
- Të shfrytëzojë kohën e duhur gjatë seansave me klientin (vizita e parë gjithpërfshirëse duhet të zgjatë së paku 40 minuta dhe seansat e ardhshme së paku 15 minuta apo më shumë);
- Të aktivizojnë dhe të ofrojnë aktivitete grupore me klientë dhe familjarë në lidhje me tema të caktuara (në pajtim me anëtarët e tjerë të ekipës);
- Të lehtësojë dhe të përkrah krijimin e grupeve-vetë-ndihmëse për klientë dhe familjarë ;
- Të merr pjesë në mënyrë aktive në të gjitha mbledhjet e stafit (ditore) dhe atyre në repartin e psikiatrik;
- Të bashkëpunon me stafin e qendrës në definimin dhe në implementimin e trajtimeve gjithëpërfshirëse individuale për çdo klient;
- Të ofrojë përkrahje dhe të bashkëpunojë me repartin e psikiatrisë në kuadër të spitalit të përgjithshëm në lidhje me përcjelljen e klientëve në QSHMnB, si dhe të jetë në gjendje gadishmërie gjatë kujdestarive të natës dhe gjatë ditës;
- Të aktivizojë përkrahje dhe dëgjim psikoterapeutik dhe të mundësojë integrimin e klientëve në grupe terapeutike dhe në jetën e përditshme të shërbimeve;
- Të sigurojë shfrytëzim racional (të kujdesshëm dhe në mënyrë korrekte) përdorimin e barërave psikotropike, të bëjë vlerësime periodike, mbledhje të dhënave dhe ti jipet vëmendje të posacme barërave me “efekt të gjatë”;
- Ti respektojë kodet e caktuara të etikës dhe të konfidencialitetit gjatë praktikës.

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Infermierit/es:

- Do të punojë si pjesëtar/e i/ e ekipit të kujdesit mjekësorë, në ofrimin e standardit më të lartë për kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientët;
- Sipas nevojës ti asistojë pacientit në mbajtje të higjienës personale, gjatë të ushqyerit, kryerjes së nevojave fiziologjike dhe aktiviteteve tjera që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien e pacientit;
- Të sigurojë komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të dhëna të sakta për pacientët për të cilët është kujdesur gjatë tërë orarit të tij/ saj të punës;
- Të u ofron pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin i cili iu ofrohet atyre;
- Të kontribuojë në mbajtje të pastërtisë dhe higjienës në mjedisin ku punon dhe të punoj gjithnjë në përputhje me udhëzuesit mbi kontrollin e infeksionit;
- Të administrojë terapinë e përshkruar në përputhje me politikën Institucionale;
- Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për parandalim të dekubitit;
- Të përdor dhe të mirëmbajë në mënyrë të duhur dhe të sigurt të gjitha pajisjet;
- Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit sipas specifikave të shërbimit;
- Të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara sipas programeve për njësi të caktuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informative në mes të personelit shëndetësor;
- Të ruajë konfidencialitet të plotë për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit apo punën e institucionit, përveç në rastet kur ajo /ai autorizohet me shkrim, në përputhje me politikën Institucionale;
- Gjithnjë të veprojë në mënyrë të tillë, që do të ndihmonte në avancimin e marrëdhënieve të mira pacient - infermier/e;
- Të marrë pjesë në aktivitetet për edukimin e vazhdueshëm profesional në mënyrë që të freskojë dhe avancojë njohuritë dhe standardet e punës infermierike;
- Zbaton protokollet e praktikave infermierore të bazuara në dëshmi, gjatë ofrimit të kujdesit infermior;
- Të kryejë edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Këshilltar/e psikosocial:

Te jete pjese e ekipit te QSHM;

Te jete pjese e ekipit multidiciplinar ne aktivitete brenda dhe jashte QSHM;

Te perpiloi raporte te detajizuara per secilin rast dhe te referoi te shefi i sherbimit;

Te ofroi sherbim adekuat psikosocial ne kuader te sherbimit te SHM;

Te aranzhoi takime me organizata Qeveritare dhe joqeveritare rreth problemeve psikosociale qe dalin nga

kerkesat e shërbimit të Qendres në koordinim me drejtorin e QSHM;
 Te respektoj detyrat dhe obligimet dhe të marrë pjesë në zbatimin e tyre;
 Te angazhohet në përcjelljen e rasteve të vecanta me trauma të luftës, trauma nga dhuna dhe trauma tjera si dhe të koordinoj nevojat e tyre specifike ;
 Ndihmon në zhvillimin dhe zbatimin e programeve individuale për të vlerësuar nevojat dhe progresin e klientëve të shendetit mendor;
 Ndërton marrëdhënie konstruktive me klientët, ndërvepron me ta dhe sipas nevojave individuale vendos pritje sfiduese por të realizueshme;
 Promovon vetë-respektin, pavarësinë dhe ndërveprimin psikosocial;
 Inkurajon klientet që t'i shprehin nevojat, mendimet dhe ndjenjat e tyre dhe aty ku është e mundur të zhvillojnë mënyra të reja të adresimit të sfidave me të cilat përballen;
 Monitoron dhe mban shënime të duhura për sjelljen e klientëve, reagimet emocionale, përfshirjen në aktivitete dhe arritjet e tyre në përputhje me objektivat e përcaktuara në kuadër të planeve individuale;
 Krijon marrëdhënie konstruktive dhe të besueshme me qëllim që të punohet në partneritet me prindërit dhe kujdestarët e tjerë;
 Prindërve dhe kujdestarëve të tjerë u ofron të dhëna në baza të rregullta rreth vështirësive, arritjeve, përparimit të anëtarit të tyre të sëmurë dhe po ashtu ofron instruksione për prindërit që disa nga mënyrat/format e punës më të sëmurin të vazhdojnë ti praktikojnë në shtëpi në mënyrë që në përmbushjen e nevojave dhe zhvillimin e shkathësive të tyre të kenë kontribut edhe prindërit;
 Këshillon familjet dhe prindërit, u jep këtyre të fundit mundësi takimi me prindër tjerë që përballen me sfida të ngjashme përmes seancave vetë-përkrahëse në Qendrën e Shendetit Mendor.

Detyrat dhe Përgjegjësitë Roje :

- bënë sigurimin e objekteve të shërbimit dhe hapësirave përreth;
- ruan automjetet që të mos vijë deri te thyerja e tyre, dëmtimi, vjedhja etj;
- në raste të vërejtjes së rrezikut nga zjarri apo rreziqeve të tjera, ndërmerre masat më efikase dhe menjëherë kërkon ndihmë për evitim të të metave;
- në raste sulmi ndërmerr masa të caktuara konformë Rregullores mbi punën e Shërbimit në sigurimin fiziko –teknik të objekteve;
- të gjitha të metat e vërejtura i shënon në libër të vërejtjeve dhe mbi të njëjtat informon zyrtarin përgjegjës;
- pranimin dhe dorëzimin e detyrës e bënë me shkrim;
- bartë bezhin në vend të dukshëm;
- përdorë aparatet kundër zjarrit, dhe udhëzimet e udhëheqësit të drejtpërdrejt;
- punët dhe detyrat e punës i kryen në pajtim me aktet e përgjithshme interno dhe udhëzimeve verbale;
- bënë kontrollimin e materialit, automjeteve dhe personave të cilët hyjnë dhe dalin në ndërtesë, njëherit në libër shënon hyrjet dhe daljet si dhe vërejtjet e tjera në kohën kur nuk punohet apo jashtë orarit;
- nuk lejon daljen e automjeteve dhe mjeteve të tjera, nëse për këtë nuk është dhënë urdhri me shkrim apo në mënyrë tjetër, nga oborri apo ndërtesa;
- shënon kohën e ardhjes dhe daljes së punëtorëve në kohën jashtë orarit të punës;
- punët dhe detyrat e punës i kryen në dy nderrime;
- në rastet e vizitës nga ana e udhëheqësit ose të punëtorit të autorizuar, i raporton mbi gjendjen dhe gjërat të vërejtura gjatë punës së tij;
- Si dhe detyrat tjera të cilat (më tutje) mund të jenë të përshkruara në përshkrimin e bashkangjitur të punës ose të caktuara nga punëdhënësi.

Kriteret e përgjithshme:

- të jetë shtetasi Republikës së Kosovës;
- të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe
- të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

Dokumentet që kërkohen:

Për pozitën mjek specialist/psikiatër:

- ✓ diplomën e fakultetit-noterizuar; certifikaten e specializimit; licencën e punës; leternjoftimin kopje; dëshmi nga gjykata që nuk është në procedura gjyqesore; ; vërtetim të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Për pozitën Infermier/e-sh.mesme:

- ✓ diplomën e shkollës së mesme-noterizuar; licencën valide nga OIK; leternjoftimin kopje; dëshmi nga gjykata që nuk është në procedura gjyqesore; vërtetim të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Për pozitën Këshilltar psikosocial:

- ✓ diplomën universitare në psikologji, pedagogji speciale, shkenca sociale-noterizuar;
- ✓ e preferuar masteri në fushën përkatëse;
- ✓ licencën valide nga institucionet përkatëse;
- ✓ një (1) vite përvojë pune;
- ✓ Leternjoftimin kopje;
- ✓ dëshmi nga gjykata që nuk është në procedura gjyqesore;
- ✓ vërtetim të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Për pozitën roje:

- ✓ shkollën e mesme-noterizuar;
- ✓ dëshmi nga gjykata që nuk është në procedura gjyqesore;
- ✓ vërtetim të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- ✓ leternjoftimin kopje;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe plotësojnë kriteret e kërkuara me konkurs si dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar sipas këtij konkursi.

Data e hapjes dhe mbylljes së konkursit: Konkursi publikohet në webfaqen e SIMBNJ për 30 ditë nga 20.05.2025 deri më 18.06.2025 pastaj dorëzimi i aplikacioneve bëhet brenda këtij afati (30 ditë), për pozitat Mjek specialist; Këshilltar psikosocial dhe Infermier/e **ndërsa për pozitën Roje afati i dorëzimit është nga data 20.05.2025 deri më 03.06.2025, 15 ditë.**

Të gjitha njoftimet e procedurave të rekrutimit bëhen përmes Web faqes së SHSKUK-së.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni (duhet të plotësohet në mënyrë elektronike) mund të shkarkohet online në SIMBNJ dhe dorëzohet në Sektorin e Burimeve Njerëzore në SHSKUK.

Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës, numri i referencës dhe emri i njësisë organizative të SHSKUK-së. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Spektori i Burimeve Njerëzore në SHSKUK

